



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.14 prot.

Himarë, më 17.10. 2025

ZBARDHJE E PROTOKOLLIT NGA ORGJINALI I MBLEDHJES TË RADHES SË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË.

Sot më datë 17.10.2025 zhvillohet mbledhje e radhës për muajin Shtator, kërkuar nga Kryetari i Këshillit Bashkiak. Hapet mbledhja në ora 10:30.

Të ftuar kryetari Bashkisë, nënkryetarët e Bashkisë, drejtoritë, administratorët e njësive, kryetarët e fshatrave.

Marrin pjesë këshilltarët :

Dhimitër Kapaj, Lenica Kocani, Elisabeta Lamaj, Aleks Llazari , Mirka Gjiçali, Timoleo Gërdhuqi, Gjergji Iliadhi, Milto Nika, Afrovita Dhimojani, Thëllëza Kokaveshi, Artionil Shirokaj, Miltiadh Prifti, Maks Vlashi, Qirjako Mërkuri, Artan Bala, Theodhori Foto, Loreta Isufi, Nikolin Laska.

Plotësohet kuorumi me 18 anëtarë.

Hap mbledhjen kryetari i këshillit. Lexohet ligjshmëria e vendimeve të muajit të kaluar.

Jeni dakort me rendin e ditës? Në rregull.

Pika e parë: Fillojmë me projektvendimin e shpërblimit të personelit të angazhuar për shuarjen e zjarreve. Votohet ky projektvendim me 16 vota pro, 0 kundër, 2 abstenim.

Pika e dytë: Po flitet për raportimin e kompanisë së pastrimit “Alko-Impeks”. Këshilltarja Dhimojani kërkon sqarime nga palët për situatën e ndodhur.

Sqaron kryetari i bashkisë për situatën e ndodhur në aksin rrugor Pilur – Kudhës.

Në replikë me kryetarin e bashkisë, këshilltarja Kokaveshi flet për raportin e sjellë nga NSHP dhe “Alko-Impeks”. Këshilltarja Gjicali në replikë me këshilltaren Kokaveshi për bllokimin e rrugës nga mbeturinat. Përsa i përket kësaj problematike sqaron administratori i “Alko-Impeks”. Vazhdojnë sqarimet për problemin e mbetjeve. Këshilltarët kërkojnë zgjidhje përfundimtare që ky problem të mos i kthehet më qytetit dhe bashkisë.

Sqaron dhe kryetari i këshillit po për këtë problematikë.

Këshilltari M. Prifti kërkon informacion mbi procedurën kontraktuale nga drejtoria e Financës dhe shumën financiare. Këshilltarja Kokaveshi propozon që ai vendgrumbullim mbetjesh, që është në Vumblo, të rishikohet dhe të gjendet mundësia të spostohet. Sqaron këshilltari Gërdhuqi dhe informon mbi atë situatë. I heq vërejtje dhe NSHP-së për atë shkelje. Ngre gjithashtu, edhe një problematikë mbi orarin e mjeteve të pastrimit.

Pika e tretë: Relacioni mbi treguesit ekonomik për perjudhen Janar – Gusht 2025. Shpjegon relacionin Drejtoria e Financës. Sqaron dhe Kryetari i Bashkisë për relacionin e treguesve ekonomik dhe për realizimin e mbledhjes së të ardhurave me shumëfishim të tyre.

Këshilltari Gërdhuqi kërkon sqarim për një pikë të relacionit ekonomik nga drejtoria përkatëse. Sqaron Kryetari i Bashkisë për disa problematika për mbledhjen e të ardhurave.

Sqaron Drejtoria e Taksa Tarifave për mbledhjen e të ardhurave nga debitorët, mënyrën se si operoi drejtoria nëpërmjet akt-marrveshjeve për shlyerjen e detyrimeve.

Flet këshilltari Nika për lehtësimin e biznesit të vogël në zonat me pak banorë, kryesisht në fshatrat larg detit.

Pika e katërt: Për propozimin e komisionit për titujt e nderit.

Kryetari i Këshillit propozon ngritjen e këtij komisioni.

Krijohet komisioni për titujt e nderit.

BF – Timoleo Gërdhuqi

PS – Artionil Shirokaj

PSD – Milto Nika

Shoqeria Civile – Amalia Rondo, Ruzhdi Barjamaj

U votua ky komision me 17 vota pro.

Pika e pestë: Shqyrtohet kërkesë-ankesa e qytetarit Lefter Lagji.

Këshilli vendoset të hapet rruga dhe të hiqet pergolata. E merr përsipër për zgjidhje të problemit Kryetari i Bashkisë.

Pika e gjashtë: Kalon për votim projektvendimi për gabimin material.

Votohet ky projektvendim me 11 vota pro, 5 vota abstenim.

Pika e shtatë: Miratohet propozimi i këshilltarëve për propozimin e projektvendimeve për tjetërsim pronash, të bëhet me votim të fshehtë.

Ky komision përbëhet nga 3 anëtare:

- Timoleo Gerdhuqi
- Mirka Gjicali
- Gjergji Iliadhi

Pika e tetë: Shqyrtohet kërkesa e qytetarëve Lulëzim Mehmetaj dhe Fejzo Zeko për servitut kalimi.

Këshilli vendosi ti kalojë drejtorisë përkatëse për zgjidhje.

Pika e nëntë: Këshilltari Gërdhuqi propozon të futet në rend dite projektvendimi për miratimin e transferimit të pasurive të llojit kullosor, me numër pasuri 3/148/1, në zonën kadastrale 3844, me sipërfaqe të përgjithshme 22 ha, nga pronësi e Bashkisë në pronësi të F.P.P.M.I.S.

Pika e dhjetë: Nisur nga propozimi i Komisionit të Mandateve, Këshilli Bashkiak miratoi ndërprerjen e mandatit të këshilltarit Fuat Mati. Kalon për votim.

17 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Mbyllet mbledhja.

Sekretari : Zaho Dedi